REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr. 319, Datë 03.11.2026

MBI

FILLIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE PËR SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË SHOQËRISË "OSMANI" SH.P.K. PËR LICENCIM NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16, 40, pika 2, gërma "a", 41, pika 1, gërma "a", dhe 136, pika 2 të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*"; neneve 4, pika 1, gërma "a", 5, pika 1, gërma "a" dhe 10, pikat 1 dhe 3 të *Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike*, të miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar; si dhe neneve 15 dhe 19, pika 1, gërma "a" të *Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s*, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 03.11.2026, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 3160/1 prot., datë 02.11.2026, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës *"Mbi kërkesën e shoqërisë "OSMANI" sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike",*

Konstatoi se:

- Shoqëria "OSMANI" sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 3160 prot., datë 23.10.2026, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shënepremte", me kapacitet të instaluar 1.860 MW, me vendndodhje në ujërat e Përroit të Moçalit të Ariut të Sharrës, degë të lumit Grabovë, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.
- ERE, në zbatim të nenit 41, pika 1, gërma "a" të ligjit nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*", dhe nenit 5, pika 1, gërma "a" të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike" e ndryshuar*, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Kontrata nr. 2452 Rep., nr. 1198/3 Kol., datë 26.11.2018, e nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE), ka një afat 49-vjeçar. Në rast të miratimit të kërkesës për licencim, kohëzgjatja e licencës do të përcaktohet nga bordi i ERE-s, brenda kufijve të parashikuar nga ligji nr. 59/2026 "*Për sektorin e energjisë elektrike*".
- Rezulton se shoqëria ka kryer për llogari të ERE-s pagesën e aplikimit për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, referuar Aneksit A të "*Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike",* miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.06.2016, e ndryshuar.
- Nga shqyrtimi i aplikimit, rezulton se:

Përputhshmëria e Aplikimit me Rregulloren

- Në përputhje me nenin 9, pikat 1 dhe 1.1 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin e kërkuar për pajisjen me licencë sipas gërmave (a, b dhe c), duke plotësuar formularin sipas formatit të përcaktuar në Shtojcën 1.
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin juridik dhe administrativ të kërkuar sipas gërmave (a, c dhe d).
- Në përputhje me nenin 9, pika 1.3 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin financiar dhe fiskal të kërkuar sipas gërmave (a dhe c).
- Në përputhje me nenin 9, pika 2 të rregullores, aplikuesi ka dorëzuar dokumentacionin specifik për licencimin në sektorin e prodhimit të energjisë elektrike sipas gërmave (a, b, c, d dhe e).

Pajisja e shoqërisë me leje dhe miratime të tjera

Shoqëria "OSMANI" sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë Kontratën nr. 2452 Rep., Nr. 1198/3 Kol., datë 26.11.2018 "*Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e hidrocentralit "Shënepremte"*, me *kapacitet prodhues 1.860 MW, në ujërat e përroit të Mocalit të Ariut dhe të Sharrës degë të lumit Grabovë, degë të lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan*"*;*
- Ka marrë miratimin për lidhjen me rrjetin e shpërndarjes të HEC "Shënepremte", me kapacitet 1860 kW, nëpërmjet shkresës së OSHEE sh.a. nr. 16936/3 prot., datë 10.09.2018.
- Është pajisur me *Leje për përdorim burimi ujor* nr. 815 prot., datë 27.12.2024, lëshuar nga Këshilli i Basenit Ujor (KBU) Seman, miratuar me Vendim të këshillit të Basenit Ujor Seman nr. 32, datë 23.12.2024, për një afat 5-vjeçar.
- Është pajisur me VNM Paraprake nr. AN160920240004, datë 22.10.2024, nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për zhvillimin e projektit *"Ndërtim i Hec Shënepremte", me kapacitet total të instaluar 1860 kW, me vendndodhje në përroin e Moçalit të Ariut dhe përroit të Sharrës, degë e lumit Grabovë, Qarku Elbasan"*.
- Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton se, rezulton se dokumentet si më poshtë janë depozituar në format fotokopje, ndaj në referencë të përcaktimeve të neni 8, pika 3, të Rregullores, vlerësohet që t'i kërkohet depozitimi në formatin origjinal ose fotokopje të njësuar me origjinalin si vijon:
  - Kontrata nr. 2452 Rep., Nr. 1198/3 Kol., datë 26.11.2018 e nënshkruar me MIE-n.
  - Vendimi KBU Seman dhe Leja për përdorimin e burimit ujor.
  - Shkresa e OSHEE sh.a. nr. 16936/3 prot., datë 10.09.2018.

Po ashtu rezulton se shoqëria duhet të plotësojë këtë aplikim dhe me dokumentacionin si vijon:

NENI 9

Formati dhe dokumentacioni për aplikim

Pika 1, Dokumentacioni i përgjithshëm për të gjitha aplikimet për pajisje me licencë

Pika 1.2 Dokumentacioni juridik dhe administrativ

- **<u>gërma "b":</u>** dëshmitë e penalitetit lëshuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve per shoqërinë dhe administratorin.

Pika 1.3 – Dokumentacioni financiar dhe fiskal

<u>gërma "b":</u> Nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar rezulton nevoja për sqarimin e ndryshimit të vlerës së investimit, si dhe për dokumentimin e burimeve të financimit të projektit. Për këtë qëllim, vlerësohet e nevojshme që shoqëria të paraqesë dokumentacionin përkatës mbi vlerën e përditësuar të investimit, burime e financimit, dhe sipas rastit, komunikimin me MIE-n lidhur me këto ndryshime.

Pika 2.1 Për t'u pajisur me licencë për prodhimin e energjisë elektrike, aplikuesi duhet të depozitojë gjithashtu:

- **<u>gërma "a":</u>** informacion më konkret për datën e parashikuar të fillimit të operimit.
- **<u>gërma "b":</u>** raportimet periodike të depozituara në MIE në kuadër të ecurisë së projektit dhe/ose përgjigjet apo qëndrimin e saj në rast se ka pasur.
- **<u>gërma "e":</u>** dokumentacionin që provon njoftimin e AKM-së për fillimin e punimeve të ndërtimit brenda periudhës së vlefshmërisë së aktit të VNM-së paraprake nr. AN160920240004, datë 22.10.2024, përfshirë, sipas rastit, dokumentacionin mbi fillimin e punimeve brenda afateve të përcaktuara nga legjislacioni mjedisor, ose një akt të ri të lëshuar nga autoriteti kompetent.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të fillojë procedurën administrative për licencimin e shoqërisë "OSMANI" sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Shënepremte", me kapacitet të instaluar 1.860 MW, me vendndodhje në ujërat e Përroit të Moçalit të Ariut të Sharrës, degë të lumit Grabovë, degë e lumit Devoll, Bashkia Gramsh, Qarku Elbasan.

2. Shoqëria "OSMANI" sh.p.k. të plotësojë dokumentacionin e aplikimit dhe të paraqesë sqarimet përkatëse lidhur me çështjet e evidentuara në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, në përputhje me kërkesat e legjislacionit në fuqi dhe të rregullores së licencimit..

3. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Garancisë së Origjinës, të njoftojë shoqërinë "OSMANI" sh.p.k. dhe Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes dijeni të vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare. Paraqitja e ankimit nuk pezullon vlefshmërinë e vendimit, përveçse kur gjykata vendos ndryshe në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI